



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 157/1 Prot.

Tiranë, më 21/01/ 2021

V E N D I M

Nr. 10, Datë 21 /01/ 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mori në shqyrtim ankesën Nr.77 regj, datë 20.07.2020, të paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”, kundër Postës Shqiptare Qendër, Shkodër, me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuar, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Lidhur me diskriminimin e pretenduar, ankuesi shpjegon sa më poshtë:

Po ju shkruajmë në emër të një grupi organizatash të aftësisë së kufizuar dhe aktivistësh, të mbledhur së bashku në kuadër të nismës “Të veprojmë për aksesueshmërinë”, mbështetur nga Lëviz Albania, një projekt i Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

Fondacioni “Së Bashku”, është themeluar më 18 qershor 2013 me vendim gjykate nr.427, në Tiranë, Shqipëri. Organizata është themeluar dhe drejtohet nga persona me aftësi të kufizuar. Misioni i Fondacionit “Së Bashku” është të promovojë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në nivel kombëtar dhe lokal. Fondacioni fokusohet veçanërisht në të drejtat për aksesueshmëri dhe jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuar, por gjithashtu merret edhe me arsimin gjithpërfshirës, pjesmarrjen në jetën publike, etj.

Gjatë zbatimit të nismës “Të veprojmë për aksesueshmërinë” dhe në bashkëpunim me organizatat me të cilat Fondacioni “Së Bashku” bashkëvepron në Bashkinë Shkodër, kemi konstatuar që Zyrat e Postës Shqiptare Qendër, Shkodër, janë të paaksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.

Dëshmitë e marra nga personat me aftësi të kufizuara, banorë të kësaj bashkie dhe monitorimi i bërë nga ekspertët e Fondacionit “Së Bashku”, pasqyrojnë qartë diskriminimin e këtij komuniteti

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

për arsye të aftësisë së kufizuar. Ata e kanë të pamundur të marrin shërbimet e ofruara nga posta qendrore sepse ka mungesë totale të rampës në hyrje të saj. Mungesa e rampës e bën të pamundur aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar, duke u mohuar atyre të drejtën për të marrë shërbimet e ofruara në mënyrë të lirë dhe të pavarur si pjesa tjetër e popullsisë.

Duke patur parasysh që një nga shërbimet e ofruara nga posta, është pagesa për aftësinë e kufizuar, e bën akoma më të rëndësishëm dhe mund të themi jetik, aksesueshmërinë e këtij objekti të shërbimit publik. Gjithashtu personat me aftësi të kufizuar nuk mund të tërheqin pagesën dhe të marrin shërbimet e ofruara nga kjo kompani publike, pa ndihmën e familjarëve të tyre të cilët duhet t'i shoqërojnë dhe në rastet e personave që lëvizin me karrocë, ata duhet të kenë forcë fizike të mjaftueshme për të kaluar barrierat e ngritura nga shkallët në hyrje të këtij subjekti të shërbimit publik.

Situata e përshkruar më sipër, përbën një mohim të barazisë ndaj këtij komuniteti. Personat me aftësi të kufizuar janë të trajtuar në mënyrë jo të barabartë, në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë. Ky është diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Përfundimisht, ankuesi kërkon nga Komisioneri marrjen e këtyre masave:

- Vendorsjen e rampës duke respektuar standartet teknike të parashikuara nga rregullorja për *“Shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*.
- Trajnimin e prsonelit për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe respektimin e dinjitetit të tyre.
- Pajisjen me sportel sipas standarteve teknike për të bërë të mundur aksesueshmërinë nga personat me aftësi të kufizuara.
- Vendorsjen e shiritave për personat që nuk shikojnë.

Masat e mësipërme që kërkohet të merren nga Komisioneri, bazohen në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Neni 9 të ligjit nr. 108/2012 “Për ratifikimin e konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”
- Neni 2, pika b dhe neni 11 i ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- Neni 4, pika i dhe neni 3, pika 37 i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
- Neni 2, pika b, neni 45/1 i VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në datën 18.11.2020, kanë fyre në fuqi ndryshimet ligjore të miratuara me ligjin nr. 124/2020 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga*

diskriminimi”². Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të pandryshuar.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”³, që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Fondacioni “Së Bashku” është një organizatë jofitimrurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr.427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por pretendon mohimin e barazisë dhe diskriminimin e personave me aftësi të kufizuar për shkak se Zyrat e Postës Shqiptare Qendër, Shkodër, janë të paaksesueshme.

Bazuar në nenin 33, pika 3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës. 8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative. 2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.”

Bazuar në këto dispozita ligjore rezulton se kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të

² Ligji nr.124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat nund të cënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Fillimisht ankuesi ka identifikuar si subjekt kundër të cilit është paraqitur ankesa, Postën Shqiptare Qendër, Shkodër. Gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se subjekti në fjalë, pra Posta Shqiptare Qendër Shkodër, është një Zyrë Postare e Filialit të Postës Shqiptare sh.a në qytetin e Shkodrës, pra një nga vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a . Posta Shqiptare Qendër Shkodër, nuk është një subjekt i veçantë që mbart të drejta dhe detyrime, por është pjesë përbërëse e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. Në lidhje me këtë moment, Komisioneri çmon të saktësojë se palë në këtë procedurë administrative është Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, me numër të identifikimit të subjektit (NUIS) J61924007N, në përgjegjësinë e të cilës është veprimtaria dhe shërbimet e ofruara në zyrën postare përkatëse, pranë filialit të kësaj shoqërie në qytetin e Shkodrës, të emërtuar si Zyra Postare Qendër, Shkodër.

Ligji Nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, **aftësinë e kufizuar**, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 3, i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Ndërsa në Kreun III, të ligjit

parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20/1 të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7 të LMD-së, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Posta Shqiptare sh.a një person juridik i cili edhe pse është në pronësi të shtetit, është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ushtron veprimtari tregtare sipas objektit të aktivitetit të saj. Posta Shqiptare sh.a ofron shërbime publike dhe merr pjesë në sektorin publik, por ajo nuk ushtron funksione, detyra apo kompetenca publike dhe nuk është pjesë e administratës publike. Posta Shqiptare sh.a, në kuptim të nenit 7, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është një subjekt privat që ofron shërbime publike dhe jo një autoritet publik.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën me nr.1084 prot., datë 23.07.2020, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Posta Shqiptare sh.a.
- Me shkresën nr.1479/1 prot., datë 29.07.2020, Posta Shqiptare sh.a, ka kthyer përgjigje, duke parashtruar qendrimin e saj si vijon:

Zyra Qendër Qytet e Filialit të Postës Shkodër është objekt në pronësi të Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a, në katin e parë të një pallati në qendër të qytetit të Shkodër. Në hapësirën rreth 1100 m2 janë katër ambjente shërbimi me hapësira të konsiderueshme, me aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuar. Në këtë godinë janë marrë masa për përshtatjen e godinës, duke vendosur rampa në hyrjen e sallave të shërbimit.

Ndër vite dhe së fundmi në vitin 2017 janë bërë investime në Zyrën Qendër Qyteti dhe vazhdojnë dhe në zyrat e tjera, ku janë krijuar kushte bashkëkohore për marrjen e shërbimit dhe janë zgjeruar hapësirat duke shtuar sallat e shërbimit. Në investimet e programuara për zyrat postare është pasur në vëmendje krijimi i ambjenteve bashkëkohore me përshtatshmëri dhe për

shtresat me aftësi të kufizuara. Filiali i Postës Shkodër kryen një gamë të gjerë shërbimesh postare dhe financiare, këto të fundit sipas marrëdhënieve kontraktuale me institucionet përkatëse.

Theksojmë që jemi të obliguar për marrjen e masave të nevojshme lehtësuese, si vendosja e shiritave për personat që nuk shikojnë dhe trajnimin në vazhdimësi të stafit të shërbimit, të cilat po planifikohen për t'u realizuar në investimet e ardhshmen.

- Me shkresën nr. 1085 prot., datë 3.07.2020, Komisioneri kërkoi informacion shtesë nga ankuesi, i cili ktheu përgjigje me shkresën datë 27.07.2020⁴, duke informuar se:

Për shkak të situatës ne nuk mund të mbledhim dëshmi të shkruara të përfaqësuesve të organizatave të aftësisë së kufizuar dhe personave me aftësi të kufizuar në Bashkinë Shkodër. Personat që kanë realizuar inspektimin në kuadër të një monitorimi që ne po hartojmë në kuadër të projektit “Të veprojmë për aksesueshmërin” kanë konstatuar se tek Posta Qendrore e Shkodrës mungon aksesueshmëria si më poshtë:

- Ka shkallë dhe nuk ka rampë.
- Mungojnë vijat me relief për të orientuar personat që nuk shikojnë
- Mungojnë sportelet e përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

Posta është vendi ku personat me aftësi të kufizuar dhe të moshuarit marrin pagesën.

- Me shkresën e datës 26.08.2020, ankuesi pasi u njoh me qendrimin e Postës Shqiptare sh,a, paraqiti pretendimet e mëposhtme⁵:

Rampa, ashtu si është paraqitur në foton bashkangjitur përgjigjes nga Posta Shqiptare, është jashtë standarteve teknike të parashikuara nga Rregullorja “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Ajo ka një gjerësi prej 80 cm ndërkohë që standartet teknike parashikojnë një gjerësi prej 120 cm. Rampa ekzistuese ndodhet në pjesën anësore të postës dhe nuk është lehtësisht e dukshme. Mungojnë parrakët mbështetës në gjatësinë e rampës. Mungojnë shiritat orientues për personat që nuk shikojnë. Mungojnë sportelet e përshtatura për personat me aftësi të kufizuar.

Për arsyet e sipërpërmendura, ne konsiderojmë që posta vazhdon të mos jetë plotësisht e aksesueshme për shkak të mosrespektimit të standarteve teknike të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuarr. Kjo e bën të vështirë ose të pamundur aksesueshmërinë e saj nga personat me aftësi të kufizuar. Ne vlerësojmë gadishmërinë e shprehur nga Posta Shqiptare për përfshirjen e masave për aksesueshmërinë në investimet e ardhshme, por konsiderojmë që këto investime duhet të jenë imediate duke respektuar të gjitha parametrat e aksesueshmërisë ashtu si është

⁴ Kthim përgjigje e datës 27.07.2020 është dërguar nga ankuesi me *email*.

⁵ Kundërshtimet e datës 26.08.2020 janë dërguar nga ankuesi me *email*.

parashikuar në rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”

- Me shkresën nr. 1037/1 prot., datë 02.09.2020, Komisioneri kërkoi nga Posta Shqiptare sh.a plotësimin e informacionit.
- Me shkresën nr. 1732/1 prot., datë 09.09.2020, Posta Shqiptare sh.a ktheu përgjigje, duke informuar se:

Posta Shqiptare sh.a në vazhdimësi investon në rikonstruksionin e ambienteve, ku një ndër kriteret është edhe krijimi i aksesit për personat me aftësi të kufizuar. Zyra Postare Qendër Shkodër ka aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuar me dismensione 150 cm x 130 cm sipas standartit teknik.

Me anë të kësaj shkrese Posta Shqiptare sh.a ka paraqitur një informacion në lidhje me objektet që janë nën administrimin e saj mbi aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar. Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion rezulton se nga 113 zyra postare, që Posta Shqiptare sh.a ka në qytete të ndryshme, rezulton se 68 zyra postare janë të vendosura në kate përdhe-shesh dhe nuk kanë nevojë për rampë, në 21 zyra postare ka rampë, në 14 zyra postare rampa është e pamundur për shkak të lartësisë së madhe ndërsa në 9 zyra postare mungon rampa, për një zyrë postare të cituar nuk është dhënë informacion.

Në vijim të shkresës së mësipërme, Posta Shqiptare sh.a, sqaron se ato ambiente që nuk ka aktualisht akses për invalidët (rampë), do të vendosen brenda vitit, pasi objektet janë në proces rikonstruksioni.

- Bazuar në urdhrin nr.129, datë 04.11.2020, Komisioneri udhëroi kryerjen e inspektimit në datën 12.11.2020, në ambientet e Zyrës Postare Qendër, Filiali i Postës Shqiptare Sh.a, në qytetin e Shkodrës, me qëllim marrjen e informacionit në kuadër të shqyrtimit të ankesës dhe në mënyrë të veçantë verifikimin e situatës së aksesueshmërisë në terren. Ky inspektim i'u njoftua Postës Shqiptare sh.a me shkresën nr. 1073/4 prot., datë 04.11.2020.

Për kryerjen e inspektimit dhe me qëllim verifikimin në terren të aspekteve të aksesueshmërisë në ambientet e Zyrës Postare Qendër, Shkodër, Zyra e Komisionerit vendosi kontakte me z.S.B, Kryetar i Shoqatës së Para-Tetraplegjikëve në qytetin e Shkodrës dhe njëkohësisht person me aftësi të kufizuar. Z.S.B, u rekomandua nga ankuesi si person i cili kishte shprehur gadishmërinë për të testuar aksesueshmërinë në këtë objekt. Z.S.B u kontaktua nëpërmjet telefonit me qëllim kryerjen e testimeve përkatëse për aksesueshmërinë e ambienteve të zyrës postare, por nuk u arrit të bëhej e mundur pjesmarrja e tij gjatë inspektimit. Qëllimi i kryerjes së këtij inspektimi ishte të verifikoheshin në terren aspektet e aksesueshmërisë pranë Zyrës Postare Qendër, Shkodër dhe për të konstatuar vështirësitë dhe pengesat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara

që duan të marrin shërbimet e ofruara pranë kësaj zyre postare. Gjatë inspektimit u realizuan foto të ambienteve të jashtme, hyrjes dhe ambienteve të shërbimit të zyrës postare.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe jo të barabartë.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Ankuesi në çështjen në objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj ndër të tjera në promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ankuesi pretendon se mungesa e aksesueshmërisë në ambientet e Zyrës Postare Qendër Shkodër, një ambient ku ofron shërbimet e saj Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, diskriminon personat me aftësi të kufizuar të cilët për shkak të mungesës totale së rampës, nuk mund të marrin në mënyrë të lirë dhe të pavarur shërbimet e ofruara nga ky subjekt, por janë të varur në marrjen e shërbimeve nga ndihma e familjarëve të tyre. Në pamjet fotografike të Zyrës Postare Qendër Shkodër, të vëna në dispozicion nga ankuesi nuk rezulton që ambienti të ketë rampë. Ankuesi i mbështet pretendimet e tij në monitorimin e bërë nga ekspertët e Fondacionit “Së bashku”. Për sa i përket monitorimit të realizuar nga ekspertët në lidhje me aksesueshmërinë e Zyrës Postare Qendër në Shkodër, ankuesi me kthim përgjigjen e datës 27.07.2020 informoi Komisionerin se konstatimet e ekspertëve në lidhje me mungesën e aksesueshmërisë në këtë objekt konsistojnë në këto drejtime: objekti ka shkallë dhe nuk ka rampë; mungojnë vijat me relief për të orientuar personat që nuk shikojnë; dhe mungojnë sportelet e përshtatura për t’iu shërbyer personave me aftësi të kufizuar. Posta Shqiptare sh.a prapësoi pretendimin për mungesën e rampës duke deklaruar se zyra postare ishte e pajisur me rampë e cila ishte e pozicionuar në pjesën anësore të godinës, fakt ky që rezultoi i provuar nga pamjet fotografike në vendosura në dispozicion nga Posta Shqiptare sh.a.

Ndryshe nga pretendimi fillestar, ku ankuesi kishte parashtruar se kishte mungesë totale të rampës, në shpjegimet e dhëna gjatë shqyrtimit të ankesës dhe konkretisht në shpjegimet e datës 26.08.2020, ankuesi parashtroi se zyra postare ishte e pajisur me rampë, por që kjo rampë ishte jashtë standarteve. Ankuesi prapësoi pretendimet e Postës Shqiptare sh.a duke sqaruar se rampa është jashtë standarteve të aksesueshmërisë për shkak se:

- Rampa është me gjerësi 80 cm ndërkohë që standartet teknike të parashikuara nga Rregullorja “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, miratuar me VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 parashikojnë që rampa duhet të ketë gjerësi prej 120 cm.
- Rampa është e vendosur në pjesën anësore të postës dhe për rrjedhojë nuk është lehtësisht e dukshme
- Mungojnë parrakët mbështetës në gjatësinë e rampës.

Posta Shqiptare sh.a kundërshtoi pretendimin e ankuesit se rampa ishte jashtë standarteve teknike duke pretenduar se dimensionet e rampës janë 150 cm x 130 cm, pra sipas tyre brenda standartit teknik. Në lidhje me aspektet e tjera të aksesueshmërisë siç janë shiritat orientues për personat që nuk shikojnë Posta Shqiptare sh.a nuk e kundërshtoi mungesën e tyre, duke pranuar detyrimin që ata kanë për vendosjen e tyre si dhe për trajnimin e stafit të shërbimit, si dhe angazhimin për përmbushjen e këtyre aspekteve të aksesueshmërisë duke planifikuar investime përkatëse për këtë qëllim.

Sipas ankuesit mungesa e rampës e bën të pamundur aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar, duke iu mohuar atyre të drejtën për të marrë shërbimet e ofruara nga kjo kompani publike, në mënyrë të lirë dhe të pavarur, duke bërë që ata të trajtohen në mënyrë jo të barabartë në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë.

Kuadri ligjor i zbatueshëm

Me ligjin nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*⁶, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*⁷. Bazuar në nenin 116, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

KDPAK përfaqëson standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1). Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalit dhe ambjentit që pengojnë pjesmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paafhtësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të

⁶ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

⁷Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës. (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDPAK, parashikohet se: *“2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun; b) për të siguruar se subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e arritshmërisë dhe shfrytëzimit për personat me aftësi të kufizuara; c) për të siguruar trajnim për pjesëmarrësit në proces lidhur me çështjet e heqjes së barrierave që ndeshin personat me aftësi të kufizuara;...”*

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*. Në nenin 3, pika 1, ky ligj përcakton se: *“Aksesueshmëri”* është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se : *“ 3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.” Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jeta e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera ofrimin e shërbimeve (neni 5/1)*

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të*

kufizuara”. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukurore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim **dhe shërbime** për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukurore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat, përfshin si ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike.(Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

Në kreun I, neni 1, pikat 19, 20, 21 dhe 22, përcaktohet se : “19. Përpunimi relievor - është përpunimi përfundimtar me reliev i sipërfaqes së ecjes. 20. Vija relievore drejtuese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes së personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të drejtimit të lëvizjes përcakton atë me ndërrimin e strukturës relievore me gjerësi së paku 40 cm. 21. Vija relievore paralajmëruese - është përpunim me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për rrezikun nga komunikacioni. 22. Fusha relievore paralajmëruese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për paralajmërim të personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar të ndryshimit të nivelit të lëvizjes.”

Në pjesën e dytë të rregullores, kreun I, nenin 8, pikat 2.10 dhe 2.11, përcaktohet se: “.....2.10.Para shkallës së parë dhe mbas asaj të fundit realizohet fusha relievore paralajmëruese në gjatësinë e plotë të krahut të shkallëve dhe me gjerësi 40 cm me vijëzime pingul me drejtimin e lëvizjes,2.11 “**Platformat e pjerrëta (rampat)**” - Konsiderohet i arritshëm kalimi i një disnivele deri në 320 cm nëpërmjet platformave të pjerrëta të vendosura njëra pas tjetrës. Rampa duhet të plotësoj kushtet: - pjerrtësi të lejuar deri në 1:20 (5%); - gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme, gjegjësisht më së paku 90 cm në hapësirat e brendshme; - shesh pushime horizontale me dimensione minimale prej 150 x 150 cm ose 140 x 170 cm në drejtim të tërthortë dhe 170 cm në drejtim gjatësor nga ana e kundërt e lëvizjes, e vendosur në çdo 10 m të gjatësisë së rampës, - sipërfaqe relievore kundër rrëshqitëse; - rrethim të ndërtuar me dorëza mbajtëse në pjesën e pambrojtur, ose në pamundësi një bordurë të paktën

me 10 cm lartësi; - dorezë mbajtëse me diametër 4 cm, e formatuar në mënyrë që mund të kapet me pëllëmbë, e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm; - rrethim i rampës, i cili gjendet në hapësirat e jashtme, doreza mbajtëse e tij e realizuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e ndjeshme nga ndryshimet termike ; - rrethim me sipërfaqe prej qelqi i shënuar dukshëm; - përdorim i shenjave të përshtatjes Pjerrësia e platformave nuk duhet t'i kalojë 8%. Janë të pranueshme pjerrësi më të larta, në rastet e përshtatshmërisë, të lidhura me zhvillimin linear efektiv të platforms.....”, në nenin 18, “Plani orientues për lëvizje në ndërtesa”, përcaktohet se: “Plani orientues për lëvizje në ndërtesë duhet të jetë i realizuar në formë relievore dhe të plotësoj kushtet në vijim: - të jetë i vendosur horizontalisht deri në 90 cm lartësi dhe vertikalisht deri në 180 cm lartësi nga kuota e dyshemesë; - të jetë i vendosur pranë hyrjes së ndërtesës; - të përmbajë informacion në shkrimin Braille; - prej derës hyrëse të ndërtesës deri te plani të ketë vij relievore drejtuese në kahje të lëvizjes; - të tregohet drejtimi për ta arritur.....”, ndërsa në nenin 21, përcaktohet se : “1. Sporteli për PAK, shfrytëzues të karrocave duhet të plotësoj këto kushte, të ketë: - sipërfaqen e sipërme të realizuar në lartësi deri në 85 cm, me lartësi shikimi jo më pak se 70 cm, i realizuar në forme konsoli me thellësi e afrimi jo më pak se 50cm; - shenja e arritshmërisë..... .2. Sporteli i përshtatur për persona që nuk dëgjojnë, ose me dëgjim të dobësuar, persona që nuk shikojnë ose me shikim të dobësuar, është sporteli me lartësi të zakonshëm, i cili duhet të plotësoj këto kushte, të ketë: - mjetin komunikues ndihmës; - nga dera kryesore hyrëse në ndërtesë deri te sporteli vendosen vijat relievore drejtuese në drejtim të lëvizjes; - shenja e arritshmërisë..... 4. Kur në sallë ndodhen tri ose më shumë sportele që shërbejnë për të njëjtin qëllim, njëri prej tyre duhet të plotësoj kushtin e përshtatjes për PAK”

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes rezultoi e provuar se, Zyra Postare Qendër Shkodër, është e vendosur në katin e parë të një pallati. Në pjesën hyrëse të saj janë të vendosura shkallë, ndërsa në pjesën anësore të hyrjes për në zyrën postare është vendosur një rampë për të mundësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara. Palët mbajnë qëndrime të ndryshme në lidhje me përmasat e rampës. Ankuesi pretendon se gjerësia e rampës është 80 cm, ndërkohë që duhet të ishte 120 cm sipas standarteve teknike, ndërsa Posta Shqiptare sh.a pretendon se rampa ka përmasa 150 cm x 130 cm. Referuar standarteve teknike që duhet të përmbushi rampa referuar rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, rezulton se rampat duhet të kenë së paku një gjerësi prej 120 cm. Duke mbajtur në konsideratë pretendimet e ndryshme të ngritura nga palët në lidhje me përmasat e rampës dhe faktin që vlerësimi i standarteve teknike kërkon një ekspertizë të cilën Komisioneri nuk e disponon, nuk u arrit të provohej se sa është gjerësia reale e rampës së vendosur në pjesën anësore të zyrës postare.

Megjithatë, sikundër pretendohet edhe nga ankuesi, se rampës i mungojnë elementë të tjerë të aksesueshmërisë siç janë parrakët mbështetës në gjatësinë e rampës, nga faktet dhe provat e administruara rezultoi e provuar se rampa nuk e përmbush këtë aspekt teknik të aksesueshmërisë i cili është i detyrueshëm sipas parashikimeve të bëra nga neni 8, kreu I, pjesa e II-të e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, në pikën 2.11 të saj.

Nga pamjet fotografike të administruara, rezultoi se nuk përmbushen gjithashtu edhe aspekte të tjera të aksesueshmërisë, siç është ekzistenca e vijave relievore që kanë si qëllim të drejtojnë dhe orientojnë personat me aftësi të kufizuara që nuk shikojnë. Mungesa e fushës relievore paralajmëruese konstatohet nga pamjet fotografike të administruara edhe në pjesën e shkallëve, një aspekt teknik ky i detyrueshëm sipas parashikimeve të nëna në nenin 8, pika 2.10, të kreut I-rë të pjesës së dytë të rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Mungesa e vijave/shiritave me relief për drejtimin/orientimin e personave që nuk shikojnë u pranua edhe nga Posta Shqiptare sh.a, e cila u shpreh se pranon dhe e njeh detyrimin që ka për vendosjen e tyre.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi gjithashtu se Zyra Postare Qendër Shkodër, nuk ishte e pajisur me një plan orientues për lëvizje në këtë ndërtesë ku ofrohen shërbimet, detyrim ky i parashikuar në nenin 18, të pjesës së dytë të rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

Pranë kësaj zyre postare ofrohen shërbime të ndryshme postare, por edhe shërbime financiare. Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Posta Shqiptare sh.a rezulton se, pranë kësaj zyre postare ndër shërbimet e ndryshme financiare janë edhe pagesa e aftësisë së kufizuar, ndihma ekonomike, të cilat kanë një efekt të drejtëpërdrejtë tek personat me aftësi të kufizuara. Pranë zyrës postare ofrohen edhe shërbime të tjera postare dhe financiare që prekin aspekte të ndryshme të jetës, të tilla si si tarifa shkollimi, pagesat e ujit, energjisë elektrike, si dhe pagesa për institucione të ndryshme shtetërore.

Bazuar në sa më sipër Komisioneri arrin në përfundimin se Zyra Postare Qendër Shkodër, nuk përmbush të gjitha standartet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Posta Shqiptare sh.a nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve të ofruara prej saj. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër.

B. Shkaku i mbrojtur

Neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me

një listë jo shteruese shkaqesh. Ky nen parashikon një sërë shkaqesh, por ndërkohë përcakton se lista e shkaqeve të mbrojtura mbetet e hapur.

Ligji parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të pabarabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.⁸

Duke mbajtur në konsideratë nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, por edhe në referim të nenit 6, të ligjit, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura dhe për të cilat nuk ekziston një arsye objektive dhe e arsyeshme.

Ankuesi ka pretenduar se situata e krijuar pranë Zyrës Postare Qender Shkodër, përbën mohim të barazisë për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, duke sjellë si pasojë trajtim të pabarabartë të personave me aftësi të kufizuara në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë. Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, diferencat në trajtim që bazohen në aftësinë e kufizuar, gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka interpretuar në kuadër të termit “*për çdo shkak tjetër*” se shkak i aftësisë së kufizuar duhet të konsiderohet shkak i mbrojtur në kuptim të nenit 14 të KEDNJ⁹.

Sikundër është theksuar më sipër, KDPAK e cila përfaqëson standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, ndalon çdo formë diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përkrah të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur

⁸ Raporti shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

⁹ GJEDNJ, Çështja *Glor kundër Zvizrës*, Nr.13444/04, 30 prill 2009.

se : “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollu 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Është KDPAK e cila parashikon në nenin 9, të saj të drejtën për aksesueshmëri si një të drejtë më vete, përpos parashikimit të aksesueshmërisë si një nga parimet mbi bazën e të cilit duhet të interpretohen të gjithë të drejtat e tjera për personat me aftësi të kufizuara. KDPAK ndalon gjithashtu çdo formë diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁰

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Zyra Postare Qendër Shkodër nuk përmbush të gjitha standartet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se jemi në kushtet e parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pasi grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standarteve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar që marrin shërbime pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Referuar Komentit të Përgjithshëm nr.6, për barazinë dhe mosdiskriminimin, miratuar në vitin 2018, nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara, në pikën 18, parashikohet se: “...Diskriminimi i drejtëpërdrejtë përfshin gjithashtu veprime ose mosveprime të dëmshme mbi bazën e një shkakut të mbrojtur, kur nuk ka një situatë të ngjashme të krahasueshme”. I njëjti parashikim bëhet edhe në Komentin e Përgjithshëm nr.20, për mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, pika 10, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore në vitin 2009.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur që në rastin konkret është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i

¹⁰ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

janë nënshkruar personat me aftësi të kufizuara, për shkak të mosrespektimit të standarteve të aksesueshmërisë të miratuar nga aktet në fuqi si më sipër janë cituar.

Sipas KDPAK, edhe pse sigurimi i aksesit në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikimi dhe shërbimet e hapura për publikun është shpesh një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, sigurimi i aksesueshmërisë mund të arrihet përmes realizimit progresiv. Kjo qasje parashikohet edhe në nenin 4, të ligjit nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të të cilit është miratuar VKM nr.1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Edhe në këtë VKM, parashikohet se planifikimi për realizimin e përshtatjes, nga ana e subjekteve të detyruara, do të realizohet në mënyrë progresive (Kreu I, pika 12). Sipas pikës 10, të kreut I, të VKM-së, parashikohet gjithashtu se: “Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë.”

Vendimi nr.1074/2015 vijon më tej duke parashikuar në pikat 9, 10, 13 dhe 14 të tij se : “9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi.10. Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. 13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara.”

Realizimi progresiv do të thotë se heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: “E drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambjentet , mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë”.

Nga faktet dhe provat e administruara nuk rezultoi që Posta Shqiptare sh.a të kishte marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standarteve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike.

Për të siguruar aksesueshmërinë, KDPAK kërkon miratimin e disa standarteve minimale që duhet të përmbushen, standarte këto që rezultojnë të jenë miratuar, sikundër është parashtuar edhe më sipër në këtë vendim.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, Komisioneri nuk është përgjegjës për vlerësimin e përmbushjes së standarteve të aksesueshmërisë në vetvete, por Komisioneri ka kompetencën që të vlerësojë nëse mungesa e standarteve të aksesueshmërisë ka sjellë ose jo si pasojë mohimin e aksesit në shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë, çështja që shtrohet në rastin konkret është nëse, mungesa standarteve teknike të aksesueshmërisë të konstatuara pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër, ka sjellë si pasojë mohimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e ofruara prej Postës Shqiptare sh.a në këtë zyrë postare?

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: *“Si minimum, situatat e mëposhtme në të cilat mungesa e aksesit ka penguar një person me aftësi të kufizuara të ketë akses në një shërbim ose objekt të hapur për publikun, duhet të konsiderohen si akte të ndaluara të diskriminimit të bazuar në aftësi të kufizuara: (a) kur shërbimi ose objekti është krijuar pas miratimit të standarteve përkatëse të aksesueshmërisë.....”*

Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e personave me aftësi të kufizuara edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme. Kwshtu qw, vendosja e një rampe (edhe pse nw rastin konkret nuk wshtw në përputhje me standartet e kërkuara), nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi që Posta Shqiptare sh.a nuk kishte marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë për personat që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë ose me shikim apo dëgjim të kufizuar.

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Posta Shqiptare sh.a me shkresën nr. 1479/1 prot., datë 29.07.2020, kjo e fundit deklaroi se në Zyrën Postare Qendër Shkodër investimi i fundit është kryer në vitin 2017, me qëllim krijimin e kushteve bashkëkohore për marrjen e shërbimit dhe janë zgjeruar hapësira duke shtuar sallat e shërbimit. Sa më sipër rezultoi se Posta Shqiptare sh.a edhe pse ka investuar për krijimin e kushteve më të mira për ofrimin e shërbimeve në këtë zyrë postare, ky investim nuk ka adresuar në mënyrë të barabartë nevojat midis personave me aftësi të kufizuara dhe pjesës tjetër të qytetarëve që nuk kanë aftësi të kufizuara. Përveç vendosjes së rampës, e cila nuk është plotësisht sipas standarteve të miratuara të aksesueshmërisë, Posta Shqiptare sh.a nuk ka investuar në asnjë drejtim tjetër për të siguruar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, sipas llojit të aftësisë së kufizuar dhe

nevojave të tyre për përshtatje. Përfundimisht rezulton se në mesin ku ofrohen shërbimet nga Zyra Postare Qendër Shkodër janë kryer investime pasi ishin miratuar standartet e aksesueshmërisë sipas Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” dhe Posta Shqiptare sh.a nuk i ka marrë në konsideratë këto standarte me qëllim eliminimin e pengesave apo barrierave ekzistuese.

Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme ka të bëjë me individin. Kjo do të thotë që detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë është një detyrë *ex ante*. Për këtë arsye, subjektet, kanë për detyrë të sigurojnë aksesueshmërinë para se të marrin kërkesa për të hyrë në një vend ose për të përdorur/marrë një shërbim, nga ana e individit. Detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, kjo do të thotë që subjekti i detyruar për sigurimin e aksesueshmërisë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t’a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Në mënyrë të kundërt, detyrimi për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën ndonjë barrë të tepruar për subjektin. ¹¹

Sikundër parashikohet edhe nga neni 9/2/c, i KDPAK, trajnimi i personelit të shërbimit në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, konsiderohet si një nga masat e duhura për eliminimin e pengesave/barrierave dhe arritjen e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Posta Shqiptare sh.a nuk vuri në dispozicion prova të cilat provojnë se stafi i shërbimit pranë kësaj zyre ka marrë trajnime në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, por ajo deklaroi se e njeh dhe e pranon detyrimin për të siguruar këto trajnime për stafin e saj dhe se për këtë qëllim po planifikohen investime për të ardhmen.

Komisioneri arrin në përfundimin se mosplotësimi standarteve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Shkodër, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a në këtë zyrë postare. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim të drejtëpërdrejtë sipas parashikimeve të nenit 3/1 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe se Posta Shqiptare sh.a është në shkelje të nenit 5, 7 dhe 20/1/b të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

¹¹ Komenti i Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, paragrafi 25

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”*

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Posta Shqiptare sh.a nuk kishte marrë masa për të siguruar standartet teknike të aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë plotësimi nga ana e Postës Shqiptare sh.a, i standarteve teknike të aksesueshmërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Lloji dhe natyra e shërbimeve që ofrohen nga Posta Shqiptare sh.a, shërbime të cilat kanë ndikim në jetën e personave me aftësi të kufizuara, siç janë pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike, kërkon me forcë marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër.
2. Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a, të marrë masa për plotësimin e të gjitha standarteve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe nr.1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe

infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, në mënyrë të veçantë në lidhje me :

- Plotësimin e të gjitha standarteve teknike në lidhje me platformën e pjerrët/rampën, sipas parashikimeve në pikën 2.11, neni 8, Kreu I, të Pjesës së Dytë të Rregullores “*Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara*”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008.
 - Plotësimin e të gjitha standarteve teknike të parashikuara në pikën 2.10, neni 8, Kreu I, të Pjesës së Dytë të Rregullores “*Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara*”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008, në lidhje me fushën relievore paralajmëruese në pjesën e shkallëve, por jo vetëm.
 - Plotësimin e të gjitha standarteve teknike në lidhje me vendosjen e vijave relievore drejtuese për të orientuar personat që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim, si dhe planin orientues për lëvizje në ndërtesë sipas parashikimeve në nenin 18, Kreu I, të Pjesës së Dytë të Rregullores “*Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara*”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008.
 - Plotësimin e të gjitha standarteve teknike të parashikuara në nenin 21, Kreu I, të Pjesës së Dytë të Rregullores “*Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara*”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008, në lidhje me sportelet e përshtatura për t’i shërbyer personave me aftësi të kufizuara.
 - Trajnimin e stafit të shërbimit pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër, në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.
3. Marrja e masave si më sipër, duhet të realizohet brenda një afati prej 3 (tre) muajsh, nga dita e komunikimit të këtij vendimi.
 4. Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a që marrja e masave për sigurimin e aksesueshmërisë së Zyrës Postare Qendër Shkodër të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.
 5. Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a që brenda 6 (gjashtë) muajve të hartojë një plan masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Bazuar në parashikimet e pikës 10, të kreut I, të VKM-së nr.1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”, pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

6. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Posta Shqiptare sh.a, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
7. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Mungesa e aksesueshmërisë në ofrimin e shërbime
Lloji i vendimit: Diskriminim
Forma : I drejtëpërdrejtë